



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE  
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 555/1 prot.

Tiranë, më 06.02.2025

Lënda: Dhënie mendimi mbi projekturdrin e përbashkët

**MINISTRISË SË BRENDSHME**

**Tiranë**

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 1003 prot., datë 29.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 555 prot., datë 31.01.2025, me anë të të cilës dërgoni për mendim projekturdrin e përbashkët “Për të dhënat e mbledhura gjatë procesit të shoqërimit, ndalimit të përkohshëm policor, ndalimit dhe arrestimit të personit” (në vijim “projekturdhri”).

Nga analizimi i përmbajtjes së aktit, vërejmë se për hartimin e tij, i referoheni pikës 3, të nenit 36, të ligjit nr. 82/2024 “Për policinë e shtetit”. Ndërkohë, në po këtë ligj, në nenin 141 të tij, citohet se: “Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të nxjerrin udhëzimin e përbashkët, në zbatim të neneve 36, pika 3, dhe 38, pika 2”.

Me qëllim koordinimin për marrjen e masave të nevojshme në këtë proces, si dhe në vijim të takimeve të zhvilluara mes përfaqësuesve të strukturës së Policisë së Shtetit (caktuar nga zv/Ministri i Brendshëm, për hartimin e Udhëzimit të përbashkët “Për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave personale për qëllime policore”, në zbatim të detyrimeve të ligjit 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”) dhe përfaqësuesve të Zyrës së Komisionerit, ju bëjmë me dije se aktualisht, është dakordësuar dhe ka nisur puna për hartimin e një akti të vetëm nënligjor, i cili do të përfshijë të dyja dispozitat, sikurse parashikon neni 141, i ligjit nr. 82/2024 “Për policinë e shtetit”.

Kjo, edhe duke marrë parasysh faktin se, akti më i përshtatshëm për trajtimin e këtyre proceseve përpunuese, të cilat grumbullojnë një sasi të konsiderueshme të dhënash personale, është ai i një Udhëzimi të përbashkët.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**